VENDIM
Nr. 1176, datë 24.12.2020

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 673, DATË 2.9.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË FUNKSIONARËVE PUBLIKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 6, të vendimit nr. 673, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas funksionit "zëvendësministër" shtohen funksionet "këshilltar/analist/ndihmës", në kabinetin e Kryeministrit, dhe "drejtor departamenti" në Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe